

KOALICIONI AD-HOC I OJQ-ve NË MBROJTJE TË QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshkatarëve Shari

20 dhjetor 2011, Prishtinë

10 ARSYE PSE DUHET TË VOTONI KUNDËR PROJEKT-LIGJIT PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT

Të nderuar/a deputetë/e të Kuvendit të Kosovës,

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit, në vijim të kësaj letre ju ofron arsyet pse nuk duhet miratuar projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, i cili është në rendin e ditës së seancës së sotme.

1. Projekt-ligji është në konflikt me Pakon e Ahtisaarit – Aneksi V, neni 4 mbi “zonat e mbrojtura”, paragrafi 4.1.7. e obligon komunën e Prizrenit që të themelojë/përcaktojë zonën e veçantë për Qendrën Historike të Prizrenit.
2. Projekt-ligji shkel Kushtetutën e Kosovës – me miratimin eventual të këtij projekt-ligji ju do të bëheni shkelës të tre parimeve themelore të kushtetutës: laicitetit, neutralitetit në çështjet e besimeve fetare dhe mosdiskriminimit. Neni 8 i kushtetutës e definojnë Kosovën shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare. Projekt-ligji parasheh themelimin e një Komiteti për Trashëgimi Kulturore (në kuadër të Kuvendit të Komunës së Prizrenit), i cili do të ketë tre anëtarë nga bashkësitë fetare, të cilët do të inkuadrohen në ushtrimin e pushtetit publik. Për më tepër, projekt-ligji parasheh që në këtë Komitet do të jenë të përfaqësuara vetëm tri bashkësi fetare, derisa në Prizren ekzistojnë edhe komunitete tjera fetare, me ç'rast mospërfshirja e tyre është shkelje e parimit të mosdiskriminimit.
3. Injorohet kuadri ekzistues ligjor dhe institucional – Kosova posedon me legjislacion të mjaftueshëm dhe institucione adekuate për mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Kushtetuta e Kosovës ofron garanci të gjera përmes neneve 9 (Trashëgimia Kulturore dhe Fetare), 58 (Përgjegjësitë e shtetit), 46 (Mbrojtja e Pronës) dhe 36 (Liria e Besimit). Për më tepër, Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Ligji për Planifikim Hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës, Ligji për Lirinë Fetare, Strategjia për Konservim të Integruar të Trashëgimisë Kulturore, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit janë garanci të fuqishme për të siguruar mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit. Institucionet si Ministria e Kulturës (Departamenti për Trashëgimi Kulturore), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren, Komuna e Prizrenit (Drejtoria për Kulturë, Drejtoria për Urbanizëm, Inspektorati i Ndërtimit) kanë për obligim implementimin e legjislacionit ekzistues për mbrojtje të trashëgimisë. Më gjithë këto garanci kushtetuese dhe kuadër ekzistues ligjor dhe institucional, përfundimisht nuk ka nevojë që Qendra Historike e Prizrenit të themelohet me një ligj qendror (sepse edhe Pakoja e Ahtisaarit e obligon komunën e Prizrenit për këtë veprim).
4. Shkelja e standardeve ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore – në analizën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore konstatohet se me këtë projekt-ligj parashihet themelimi i “njësisë administrative të veçantë”. Kjo praktikë e menaxhimit të kësaj zone të qytetit, sipas KKTK “është në kundërshtim me parimet, praktikat dhe normat ndërkombëtare për mbrojtje të qendrave historike; (Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore, UNESCO, Paris 1972; Karta për mbrojtjen dhe konservimin e qyteteve historike dhe sipërfaqeve urbane, ICOMOS, Washington 1987; Udhëzuesi për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore, Bernard M.Fellden & Jukka Jokilehto, ICCROM, UNESCO, ICOMOS, 1998, etj).

5. Injorimi i Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit – Komuna e Prizrenit, në vitin 2008 ka miratuar *Studimin dhe Planin e Konservimit*, i elaboruar në metodologji bashkëkohore të konservimit dhe zhvillimit të Qendrave Historike, i cili është punuar nga planerë të konservimit urban (ekip ndërkombëtar). Në projekt ligjin për Qendër Historike në Prizren, rregullat për zhvillime bashkohore janë përcaktuar duke mos përfillur parametrat e definuar në Studim/Master Plan të Konservimit. Dukuria e mospërfilljes së Planit të Konservimit dhe të krijimit të autoriteteve kontrolluese dhe vendimmarrëse jashtë sistemit ligjor të administrimit shtetëror, krijon mundësi që zhvillimet bashkëkohore në Qendrën Historike të Prizrenit të bëhen në mënyrë jo të duhur, me rregulla dhe kritere joprofesionale, me paragjykime dhe diskriminime. Këto veprime klasifikohen si të padrejta, të cilat në mënyrë direkte do të cenojnë integritetin dhe autenticitetin e trashëgimisë kulturore dhe të drejtat njerëzore. Prandaj, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor ka rekomanduar që projekt-ligji në përbërjen e prezantuar duhet të suspendohet.
6. Shkelja e vullnetit të qytetarëve të Prizrenit – Në vitin 2009, Forumi për Trashëgimi Kulturor i Prizrenit ka reaguar për procesin e mbyllur të hartimit të projekt-ligjit, ndërsa gjatë viteve 2010 dhe 2011 shoqëria civile e Prizrenit ka tentuar aktivisht që të hapë procesin e hartimit të projekt-ligjit. Peticioni i qytetarëve të Prizrenit për të kundërshtuar projekt-ligjin ka mbledhur mbi 10.000 nënshkrime, ndërsa ky vullnet është duke u shkelur sistematikisht nga qeveria e Kosovës.
7. Shkelja e vullnetit konsensual shoqëror kundër projektligjit – gjatë vitit 2011, në kundërshtim të projekt-ligjit janë deklaruar: qytetarët e Prizrenit përmes Peticionit me mbi 10.000 nënshkrime, shoqëria civile e qytetit, komuniteti afarist i Prizrenit, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor, Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës, Kuvendi i Kosovës (në seancë plenare dhe përmes komisionit funksional), Kuvendi i Komunës së Prizrenit, intelektualët, profesionistët dhe ekspertët e trashëgimisë kulturore. Ekziston një konsensus i gjerë shoqëror kundër këtij projekt-ligji. Prandaj natyrshëm shtrohet pyetja se kujt i konvenon dhe pse po miratohet një projekt-ligj, derisa një shoqëri e tërë është deklaruar shumë herë kundër tij.
8. Projekt-ligji diskriminon në baza fetare dhe nxit urrejtjen dhe konfliktin fetar – projekt-ligji parasheh themelimin e një Komiteti brenda komunës së Prizrenit, brenda të cilit fut përfaqësues të tri bashkësive fetare të Prizrenit. Përveç faktit që ky transferim i pushtetit publik është në kundërshtim me kushtetutën dhe karakterin laik të shtetit të Kosovës, në të njëjtën kohë, duhet kujtuar se Prizreni ka edhe bashkësi të tjera fetare dhe ky lloj përjashtimi paraqet shkelje të parimit kushtetues të mosdiskriminimit. Në fazën e hartimit dhe sponsorimit të këtij projekt-ligji, në Prizren janë shfaqur shenjat e para të konflikteve fetare, për shkak të tendencës për t'iu dhënë pushtet publik bashkësive fetare dhe për shkak të privilegjimit të hapur të Kishës Ortodokse Serbe në raport me bashkësitë tjera fetare. Dilema legjitime në raport me projekt-ligj në momentin e miratimit të tij është se do të jetë bazë për urrejtje dhe konflikte më të ashpra fetare në Prizren.
9. Projekt-ligji ngufat zhvillimin ekonomik të qytetit – Pjesa zhvillimore brenda projekt-ligjit është shumë e mangët, ndërsa imponohen shumë pengesa, ndalesa, burrokraci, mbindërtime institucionale, dënime dhe nuk parashihen kompensimet. Projekt-ligji është më shumë kufizues se sa rregullues. Nuk parashihet një sistem i qëndrueshëm i menaxhimit urban për Qendrën Historike të qytetit, i cili paraqet njërin nga potencialet themelore zhvillimore të qytetit të Prizrenit.
10. Projekt-ligji është hartuar në një proces plotësisht të mbyllur – OJQ-të e Prizrenit kanë treguar se grupi punues për projekt-ligjin, në kuadër të MMPH-së nga viti 2009 ka punuar në fshehtësi të plotë, ndërsa në grupin punues ka ftuar vetëm nga një përfaqësues të institucioneve relevante, duke e lënë shoqërinë civile jashtë procesit. Komuna e Prizrenit ka patur vetëm një përfaqësues në këtë grup punues, ndërsa asnjë herë nuk janë zhvilluar konsultime publike me qytetarët e Prizrenit në pajtim me Rregulloren e Qeverisë. Zyra Civile Ndërkombëtare dhe udhëheqësi i kësaj zyreje Z. Peter Faith, aktivisht dhe publikisht avokojnë për nevojën për një ligj për Qendrën Historike të Prizrenit, duke i nxitur institucionet shtetërore të hartojnë dhe miratojnë sa më parë këtë ligj, edhe pse kjo praktikë është në kundërshtim me Planin e Ahtisaarit. Nën presionin e ICO, MMPH pa zhvilluar konsultime publike për projekt-ligjin, e ka proceduar atë në Kuvendin e Kosovës për miratim. Kuvendi i Kosovës e ka refuzuar projekt-ligjin në lexim të parë dhe e ka kthyer në qeveri, ndërsa kjo e fundit, pas një jave e ka dërguar projekt-ligjin përsëri në Kuvend, pa ndryshuar as edhe një fjalë në përmbajtjen e tij.

REKOMANDIM

Si të dilet nga kjo situatë?

1. Të hedhet poshtë projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit,
2. Të respektohen dhe të gjejnë zbatim ligjet dhe institucionet ekzistuese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore,
3. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të marrin vendim për përfshirjen e Qendrës Historike të Prizrenit në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përhershme,
4. Komuna e Prizrenit, në përputhje me obligimin që del nga Pakoje Ahtisaarit, të iniciojë procesin e themelimit/përcaktimit të Qendrës Historike të Prizrenit,
5. Në nivel praktik, komuna e Prizrenit të themelojë një grup punues ndërsektoral, në përbërje të cilit do të jenë edhe përfaqësuesit e qeverisë qendrore dhe institucioneve tjera relevante,
6. Shoqëria civile e Prizrenit të jetë pjesë përbërëse e këtij grupi punues dhe të ketë numër të konsiderueshëm anëtarësh, për të siguruar përfaqësim të duhur të të gjitha grupeve të komunitetit,
7. Gjatë procesit të themelimit/përcaktimit të Qendrës Historike të Prizrenit nga komuna e Prizrenit, të merren parasysh ligjet ekzistuese të Kosovës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, për të shmangur dyfishime ligjore dhe institucionale,
8. Ligji për Trashëgiminë Kulturorë, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Konservimin e Integruar të Trashëgimisë Kulturore (MKRS) dhe Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit (KK Prizren) të konsiderohen dokumente referencë dhe udhërrëfyes për themelimin/përcaktimin e Qendrës Historike të Prizrenit,
9. Të organizohet një konferencë ndërkombëtare për të diskutuar praktikën e mira botërore të themelimit dhe menaxhimit të Qendrave Historike. Në konferencë të ftohen: menaxherë urban nga qytete evropiane, ekspertë ndërkombëtarë të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, institucionet shtetërore të Kosovës (qendrore dhe lokale) dhe institutet e agjencitë e specializuara (KTK, IKMM, IKPH, IAK, etj.), ekspertë vendorë të trashëgimisë kulturore, planifikimit hapësinor, menaxhimit urban, historisë, shoqëria civile, komuniteti dhe palët e interesit,
10. Të organizohen konsultime publike me të gjitha grupet e komunitetit në Prizren, për të përfshirë nevojat dhe sugjerimet e tyre në formalizimin dhe menaxhimin e Qendrës Historike të Prizrenit,
11. Komuna e Prizrenit të hartojë Planin e Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit,
12. Kuvendi i Komunës së Prizrenit të miratojë një Rregullorë komunale, përmes së cilës do të themelohet/përcaktohet Qendra Historike e Prizrenit.

NË RAST SE ZGJEDHNI TË BËHENI SHKELËS

të Pakos së Ahtisaarit, Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, standardeve ndërkombëtare, vullnetit të qytetarëve

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit, në rast të miratimit të këtij projekt-ligji në seancën e 20 dhjetorit do të ndërmarrë veprime më radikale. Hapi i parë do të jetë dërgimi i ligjit në Gjykatën Kushtetuese, pasi që ai qartë e shkel Kushtetutën e Kosovës. Paralelisht, në rast se komuna e Prizrenit e pranon këtë ligj, do të nisim procedurën e largimit të kryetarit të komunës së Prizrenit nga detyra, një e drejtë që na garantohet me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Dhe së treti, qytetarët e Qendrës Historike të Prizrenit do të praktikojnë padëgjueshmëri qytetare ndaj shtetit dhe obligimeve shtetërore. Ne besojmë se në rast se shteti shkel dhunshëm vullnetin e qytetarëve, atëherë edhe qytetarët kanë të drejtë të mos e respektojnë shtetin.

Shpresojmë që sot Ju, si përfaqësues të popullit të Kosovës, gjatë votimit të pikës së pestë të rendit të ditës: do t'i thërrisni arsyet, do të veproni në pajtim me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, si dhe do të tregoheni të përgjegjshëm në raport me vullnetin e qytetarëve.

NË TË KUNDËRT, JU DO T'I BARTNI PASOJAT POLITIKE DHE MORALE TË NJË VEPRIMI DHUNUES NDAJ DEMOKRACISË DHE PARALIZUES NDAJ FUNKSIONALITETIT TË QYTETIT TË PRIZRENIT